

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Stuhia e fuqishme godet verilindjen e SHBA-së, 100 mijë shtëpi mbeten pa energji elektrike. Anulohen e dhe qindra fluturimet
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/26/stuhia-e-fuqishme-godet-verilindjen-e-shba-se-100-mije-shtepi-mbeten-pa-energji-elektrike-anulohen-edhe-qindra-fluturimet6546546/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 21:00:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	26 shtator 2026, 20:58:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 26 shtator 2026, 20:57:00 UTC → 26 shtator 2026, 20:59:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	dc342f7c004e122e8c7c4c52a1e39d3ae51fc8471e3936c9ac886e319e0146bc
TEKSTI	9efbfffe849ff36dbbda8b621fa9ce76db83284a80e4350c1d9f92b9bb09d7e6f
PAMJA	ba971b94806d9900b2680be591536ed6fd3190ca882c8dc75df21ce44f211968

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e4678d35dd3ca284d8242f88e6d7c4f3cd2102bd7c166093233d0b85f8f9b40b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	d57e76f0635dd627857df971352a88661d14843f3cba35c03307d6141131e1c1
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e4678d35dd3ca284d8242f88e6d7c4f3cd2102bd7c166093233d0b85f8f9b40b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA TË FUNDIT

Stuhia e fuqishme godet verilindjen e SHBA-së, 100 mijë shtëpi mbeten pa energji elektrike. Anulohen edhe qindra fluturimet

26/09/2026 22:58



Një stuhi e fuqishme ka goditur verilindjen e Shteteve të Bashkuara, duke shkaktuar përmbytje, erëra të forta, reshje të dendura shiu dhe ndërprerje të energjisë elektrike në disa zona.

Rreth 100 mijë shtëpi mbeten pa energji të shtunën, ndërsa autoritetet kanë paralajmëruar për kushte të rrezikshme gjatë ditëve në vijim. Dhjetëra miliona njerëz ndodhen në zonat e prekura nga stuhia, e cila pritet të vijojë të ndikojë në rajonin e Atlantikut të Mesëm dhe në New England gjatë gjithë fundjavës.

Meteorologu kryesor i Shërbimit Kombëtar të Motit në College Park, Maryland, Bob Oravec, tha se priten "erëra shumë të forta, baticë të lartë dhe mundësi për reshje të dendura shiu" gjatë ditëve të ardhshme në verilindje të SHBA-së. Në qytetin bregdetar Surf City, në New Jersey, uji përmbiti rrugët dhe hyri në disa banesa.

Kenny Formica, pronar i një marine në bregdetin e New Jersey-t, tha se po përpiqej të ndiqte situatën nga shtëpia përmes kamerave të sigurisë, ndërsa niveli i ujit brenda marinës vazhonte të rritej. Sipas tij, përmbytja e ndërtesës është një ngjarje e rrallë. Herën e fundit që kujton një situatë të tillë ishte gjatë uraganit Sandy, i cili, sipas tij, shkaktoi më shumë se 4 milionë dollarë dëme në biznesin e tij.



Para mbërritjes së stuhisë, punonjësit siguruan litarët e ankorimit, zhvendosën sendet dhe pajisjet që mund të dëmtoheshin dhe parkuan kamionët dhe mjetet e marinës në pjesën më të lartë të pronës. Por deri të shtunën në mëngjes, edhe ato ishin pothuajse të rrethuara nga uji.

Formica tha se gjatë mëngjesit mori mesazhe nga klientë që raportonin se u ishin zhdukur varkat dhe mjetet e ujit. Një prej tyre i dërgoi një video rreth orës 04:00, ku shihej varka e tij 7.6 metra e gjatë, e cila ishte shpëputur nga vendi ku ishte ankoruar.

Kryesore



"Policia dhe protesta, njësoj si në Tiranë"/ Rama nga SHBA: Njëri kishte ardhur nga Britania për të më gjuajtur me vezë, shefi ishte shqiptar

20:29

Aksidenti i rëndë në Thumanë, tre mjete përplasen me njëra-tjetrën, humb jetën një 19-vjeçar, plagosen dhe dy persona

07:38

SPAK aksion në Shkodër e Tiranë për arrestimin e personave me rrezikshmëri të lartë, një në pranga, Endrit Dokle shpallet sërish në kërkim

10:57

Atentat në Athinë, katër persona hapën zjarr drejt një kafeneje, plagoset një fëmijë shqiptar

07:59

Teherani ofroi armëpushim 7-ditor, Wall Street Journal: Trump e refuzoi dhe kërkoi që bombardimet ndaj Iranit të vijojnë pas zgjedhjeve të nëntorit

08:12

Më të lexuarat

Pushimet kthehen në tragjedi, motër e vëlla nga Shqipëria dhe partnerët e tyre humbin jetën pas shembjes së godinës në Athinë

Thirrja urgjente/ Rama mesazh shqiptareve nga Rinasit direkt pas kthimit nga SHBA, zbardhen detajet

Ekskluzive/ Mbyllen hetimet për vrasjen e gjyqtarit Astrit Kalaja, prokuroria i komunikoi akuzën autorit Elvis Shkambi

VIDEO/ Shqipëria në versionin "turbo", kuqezinjtë dominojnë Bjellorusinë dhe marrin 3 pikë të merituar

Statusi i Saimir Tahirit në Facebook, miqtë e tij tregojnë për Top Channel çfarë pritet të thotë ish-ministri i brendshëm socialist

Fusha kthehet në ring! Lukaku bën gjestin e turpshëm ndaj italianëve, Donnarumma humb toruan dhe vërsulet drejt tij

Shpërthimi i fuqishëm në Athinë ku humbën jetën 3 shqiptarë, ekipet e emergjencës nxjerrin trupat e 6 viktimave nga rrënojat

Berisha pa ftesë për ceremoninë e prezantimit të Wendt si ambasador i SHBA në Shqipëri, kreu i PD: Nuk jam ftuar as për mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare

"Është një varkë prej rreth 3.6 tonësh dhe kushton 150 mijë dollarë, thjesht u zhduk", tha Formica.

Edhe në Edgewater, New Jersey, përgjatë lumit Hudson, uji përfshiu një parkim të madh të mbushur me makina. Në pamjet e publikuara në rrjetet sociale, një makinë dukej pothuajse tërësisht nën ujë, me vetëm çatinë panoramike mbi sipërfaqe, ndërsa njerëzit përpiqeshin të zhvendosnin automjetet e tjera larg ujit.

Stuhia anulon fluturimet dhe ndryshon aktivitetet

Stuhia ka detyruar shumë njerëz të ndryshojnë planet e tyre. Qindra fluturime u anuluan në aeroportin Logan të Bostonit, ndërsa pjesa më e madhe e fluturimeve drejt destinacioneve turistike Martha's Vineyard dhe Nantucket u anuluan gjithashtu. Edhe sporti u prek nga moti i keq. Boston Red Sox dhe Chicago Cubs, të cilat po përgatiteshin për fazën e play-off-it gjatë fundjavës së fundit të sezonit të rregullt të Major League Baseball, u detyruan të ndryshonin kalendarin e ndeshjeve.

Dy skuadrat zhvilluan një ndeshje të dyfishtë të premtën në Boston për të shmangur stuhinë. Më pas, MLB vendosi që ndeshja përmbyllesë e serisë të dielën të zhvillohej në Florida, në stadiumin e Tampa Bay Rays. Ndërkohë, këngëtari Ed Sheeran anuloi koncertet e tij të së premtes dhe të së shtunës në stadiumin Gillette në Foxborough, Massachusetts.

Më në jug, mbyllja e një autostrade në ishullin Hatteras të Karolinës së Veriut prishi planet për dasmën e Jayden Sink dhe Kimberly Laprad.

Çifti nga Virxhinia kishte arritur të hynte në ishull përpara stuhisë, por rreth 45 të ftuar mbetën në anën tjetër të rrugës së bllokuar. Një kamping lokal ofroi një vend të ri për ceremoninë, kabina dhe një person për të drejtuar dasmën, ndërsa një DJ u ofrua të siguronte muzikën.

Ish-agjenti i CIA u sugjeron amerikanëve të jetojnë në Shqipëri, Bustamante: Nëse do të doja të zhvendosesha në Evropë, Shqipëria do të ishte në radarët e mi

"Disa histori i kam jetuar, të tjera...", çfarë po paralajmëron ish-ministri Tahiri, publikon videon 'enigmatike': Kam shumë për të thënë

Autoritetet bëjnë thirrje për kujdes

Stuhitë e këtij lloji nuk janë të pazakonta në New England gjatë vjeshtës, por kjo stuhi ka mbërritur më herët se zakonisht në sezon. Autoritetet në disa shtete përgjatë bregut lindor u kanë bërë thirrje banorëve të tregohen të kujdesshëm dhe të ndjekin parashikimet e motit. Guvernatori i Delaware, Matt Meyer, u kërkoi banorëve të qëndrojnë të informuar për zhvillimin e situatës. Ndërsa guvernatorja e New York-ut, Kathy Hochul, tha se përmbytjet bregdetare përbëjnë kërcënimin kryesor, por paralajmëroi gjithashtu për reshje të dendura, erëra të fuqishme dhe dallgë që mund të arrijnë deri në gjashtë metra lartësi.

"Shiu ka nisur dhe, edhe pse deri tani kanë rënë vetëm rreth 1.3 centimetra, shumë më tepër reshje po vijnë", tha Hochul të shtunën në mëngjes.

Top Channel

I Bota »





Top Channel publikoi videon e Peter Magyar, ja si reagon kryeministri hungarez (FOTO)

26/09 22:50



Fotografoi anijen "Vlora" në vitin 1991, ndahet nga jeta fotoreporter i që dokumentoi eksodin e shqiptarëve drejt Italisë

26/09 21:15



Polonia "merr me të mirë" SHBA-në, Trump: 15 mijë dollarë për cdo ushtar amerikan të stacionuar atje

26/09 19:28



Princi Harry rikthehet në Britani pas 6 vitesh: Fantastike të jem sërish në tokën britanike

26/09 17:37



Tensionet SHBA-Iran, Trump konfirmon refuzimin e armëpushimit: Teherani ofroi rihapjen e Hormuzit dhe rikthimin në negociata

26/09 17:14



Papa Leone XIV në Francë/ Mesazhe për migrantët dhe të rinjtë. 700 mijë besimtarë në meshën në Paris, më pas drejt Lourdes

26/09 17:03

Na ndiqni:



I Video »



Top Channel/ Vrasja e gjyqtarit, mbyllet hetimet. Prokuroria i komunikon zyrtarisht akuzën autorit



Top News- Reliket e princit në frontin e Ukrainës, Kisha ruse: Mbështetje shpirtërore për trupat



Top News – Trump 'dëbon' LGBTQ/ Jo mbrojtje për personat me orientim ndryshe seksual



Top Channel/ "Populli s'të do", protestuesit: Skandali i SHISH nuk është rozë, por rënia e shtetit



Top News – Irani 'gropos' armatën. Teherani – Armiqtë nuk i njohin kapacitetet tona ushtarake



Top News- Trump paralajmëroi Kinën për Iranin/ Prapaskenat e takimit me Xi Jinping, zbardhen detajet

Lajme

Lajmet e fundit
Politikë
Kronikë
Aktualitet
Ekonomi
Sociale
Video
Top News LIVE

Bota

Opinion
Koment
Kosova dhe Rajoni
Shkencë dhe Teknologji
Auto

Sport

Kombëtarja
Kategoria Superiore
Kategoria e Parë
Premier League
La Liga
Serie A
Shumësportësh
Sport Gossip

Pop News

Showbiz
Lifestyle
Fashion
Shëndeti
Dieta
Receta gatimi

Programe

Big Brother VIP
Për'puthen
Shqipëria LIVE
Fiks Fare
Video
Të gjitha programet
Guida TV

Top Channel

Rreth Top Channel
Kontakt
Bileta – Portokalli
Puno në Top Channel
Privacy Policy & Terms of Use
Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.